

RAPORTI I PUNËTORISË SË VIZIONIMIT PËR PARKUN PËRBALLË GJIMNAZIT “REMZI ADEMAJ”



maj, 2018

RAPORTI I PUNËTORISË SË VIZIONIMIT PËR PARKUN PËRBALLË GJIMNAZIT “REMZI ADEMAJ”

autorë:

Ardian Muçaj
Fati Çeku

Ky raport është përgaditur në kuadër të projektit “RIKTHIMI I QYTETIT - E Drejta mbi Qytetin për grupet e nënpërfaqësuar të komunitetit në Prizren”, i përkrahur financiarisht nga National Endowment for Democracy.



**National Endowment
for Democracy**

Supporting freedom around the world



Përmbajtja

- 5** **Hyrje**
- 7** **Lokacioni**
- 9** **Qellimi i punëtorisë**
- 11** **Pjesëmarrëset e punëtorisë**
- 13** **Metodologjia dhe mjetet e punës**
- 13** **Materialet e punëtorisë**
- 14** **Fazat e punëtorisë**
- 16** **Ecuria e punëtorisë**
- 17** **Rezultatet e punëtorisë**
- 22** **Identifikimi i problemeve**
- 24** **Zgjidhja**
- 30** **Konkludimi**
- 31** **Vizuelizimet**

Hyrje

Hapësirat publike janë inde që e vënë në funksion një qytet. Këto hapësira të cilat lidhin njeriun me qytetin duhet të jenë të dizajnuara në mënyrë që t'i shërbejnë të mirës publike dhe në të njëjtën kohë të jenë të shfrytëzueshme nga të gjitha kategoritë e shoqërisë. Një hapësirë e mirë publike nuk aplikon përjashtime as për të moshuarit, as për personat me nevoja të vecanta, as për gratë apo fëmijët. Pra një hapësirë e denjë publike ofron barazi ndërmjet grupeve të ndryshme të komunitetit.

Mosfunksionimi i parimit të barazisë në shfrytëzimin e këtyre hapësirave del të jetë pikërisht një nga problemet kryesore në qytetin e Prizrenit. Duke u bazuar në hulumtimet e mëhershme del të jetë se hapësira të caktuara nuk shfrytëzohen njëjtë nga burrat dhe gratë meqenëse për disa kategori të komunitetit është krijuar papërshtatshmëri për të qenë pjesëmarrës/e në zona të caktuara të qytetit, me një theks të veçantë për gratë dhe vajzat në këtë rast. Për të krijuar qytete më të qëndrueshme ne duhet të zhvillojmë hapësira ku secili ndihet i sigurtë, i lirë nga frika e dhunës, ku nevojat e burrit dhe gruas njihen dhe përmbushen, dhe ku njerëzit mund të kenë lehtë qasje në të mirat e ofrueshme. *(UN Habitat, 8)* Për këtë arsye planifikimi dhe dizajnimi i hapësirave publike duhet të nënkuptojë krijimin e lokacioneve me karakteristika që rrisin ndjenjën e sigurisë dhe mirëpritjes për një grua apo një vajzë, në mënyrë që ky grup i shoqërisë të ndihet i dëshiruar me prezencën e vet në realizimin e aktiviteteve ditore, në hapësirën të cilën ato shfaqin nevojë apo dëshirë për shfrytëzim.

Deri në vitet e vona hapësira shtëpiake është parë si një pjesë e vetme e cila i përket një gruaje dhe këtu sfera publike plotësisht është ndarë nga ajo. Mirëpo në ditët e stome, kur një grua është e angazhuar me obligime të shumta ajo domosdoshmërisht bëhet shfrytëzuese e hapësirave publike. Nëse këtë grua e shohim si një nënë, arsyet për ta shfrytëzuar hapësirat e qytetit nga ajo veçse fuqizohen nga nevoja për ta shëtitur fëmijën jashtë, për ta sjellur në një kënd të lojërave, dërgimin në shkollë, apo për të kryer nevojat e tjera të saj si një nënë aktive.

Gratë vazhdojnë të kategorizohen si një grup i shoqërisë që ende hasin në pengesa të mëdha kur vjen fjala tek shfrytëzimi i përbashkët i disa lokacioneve. Rezultatet e puntorisë “Hapësira publike të sigurt dhe mikpritëse për gratë dhe vajzat” do t'i sjellin në pah një sërë problemesh me të cilat këto gra ballafaqohen në baza ditore.



Lokacioni

Lokacioni i trajtuar paraqet hapësirën publike përballë Gjimnazit “Remzi Ademaj”, në afërsi të lumit Lumbardh dhe objekteve me rëndësi të trashëgimisë kulturore si Objekti i Beledijes, Xhamia e Suzi Qelebesi dhe Ura e Suzi Qelebisë. Përbën një pikë lidhëse në mes të Qendrës Historike të Prizrenit dhe pjesës perëndimore të qytetit. Ky park në fakt paraqet një zgjerim të segmentit të Kejit i cili zhvillohet në rrjedhën e Lumbardhit. Lokacioni në fjalë paraqet një hapësirë publike me potencial shfrytëzimi nga banorët të shtëpive përgjatë dy anëve të lumit, gjimnazistëve, kalimtarëve të rastit, turistëve, punonjësit e institucioneve në afërsi dhe grupve të tjera të komunitetit.





Qëllimi i puntorisë

Puntoria e vizionimit “Hapësira publike të sigurt dhe mikpritëse për gratë dhe vajzat” është realizuar në kuadër të projektit “Rikthimi i Qytetit, E Drejta mbi Qytetin për grupet e nënpërfaqësuar të komunitetit në Prizren”, me përkrahje të National Endowment for Democracy.

Siguria në hapësirat publike rezulton të jetë një ndër shqetësimet kryesore në Komunën e Prizrenit. Kjo problematikë është një nga të gjeturat e hulumtimit të mëparshëm “Siguria në Hapësirat Publike” dhe në ligjëratat e mbajtura me Shkollat e mesme të ulta të Prizrenit, të realizuara në kuadër të NED. Mbajtja e një puntorie vizionuese ka ardhur si rezultat i mungesës së hapësirave të mjaftueshme publike në dispozicion të qytetarëve dhe nga vetë kërkesa e banorëve për funksionalizimin e parkut që gjindet përballë shkollës "Remzi Ademaj".

Gratë dhe vajzat e komunës së Prizrenit ende ballafaqohen me probleme bazike urbane. Bazuar në analizën “Planifikim urban për qytetarët 5” të realizuar nga EC në vitin 2017 del se gratë ende janë pjesë e një grupi të marginalizuar që vazhdimisht hasin në pengesa për të zhvilluar një rutinë normale ditore në hapësirat publike. Kjo analizë na lë të kuptojmë se si shqetësim i grave shfaqet mungesa e hapësirës së gjelbëruar, bllokimii trotuareve, siguria në rrugë dhe ngacmimet seksuale. Këto çështje mjaftojnë që ky grup i komunitetit të marginalizohet dhe të mos jetë pjesë aktive e shoqërisë.¹ Pra, mënyra e dizajnit të hapësirave brenda për brenda qytetit është bërë në atë mënyrë që grupe të caktuara të dominojnë mbi një grup tjetër në shfrytëzim të qytetit. Ky raport tenton që të jap shembuj se si një hapësirë e mirë publike, me ndriçim të mjaftueshëm, me elemente që sjellin qarkullimin e njerëzve dhe me intervenime që sjellin ngrohtësi në një ambient, mund të krijohen zona të cilat i mirëpresin të gjitha kategoritë e komunitetit dhe më e rëndësishmja, t’iu ofrojnë atyre siguri.

Qëllimi i kësaj puntorie është identifikimi i nevojave dhe kërkesave të grave dhe komunitetit më të gjerë në mënyrë që të dizajnohet një zgjidhje e qëndrueshme urbane e cila do ta vinte këtë lokacion në shërbim të të gjitha kategorive të shoqërisë. Këto propozime konkrete janë të përkthyer në vizualizime të cilat i përcillen autoriteteve lokale për intervenime direkte në terren - që rrjedhimisht sjellin përmbushjen e kërkesës së këtyre banorëve dhe vënë në funksion një arterie të rëndësishme të qytetit të Prizrenit.

¹ http://ecmandryshe.org/repository/docs/170209170458_08_12_2016_RBASHA_Analiza_5_Planifikimi_Urban_per_Qytetare_Final.pdf



EC National Endowment for Democracy

RIKTHIMI I QYTETIT

E Drejta mbi Qytetin
për grupet e
pënpërfundësuar të
Prizren

Pjesëmarrëset e puntorisë

Punëtorja “Hapësira publike të sigurta dhe mikpritëse për gratë dhe vajzat” kishte si synim mbledhjen e një grupi të grave dhe vajzave duke e marrë parasysh se ato ishin grupi që më së shumti e ka ngritur zërin mbi problemin e hapësirës së parkut përballë shkollës “Remzi Ademaj”, por kategoritë e tjera të shoqërisë kanë qenë gjithashtu të ftuara për të marrë pjesë dhe kontribuar në funksionalizimin e kësaj hapësire. Pjesëmarrësit kanë ofruar propozimet e tyre duke u bazuar në përvojat e tyre ditore lidhur me këtë hapësirë.

Duke qenë se përballë këtij parku gjendet shkolla “Remzi Ademaj” dhe frekuentuesit më të mëdhenjë të këtij parku gjatë ditës janë pikërisht nxënësit e këtij institucioni, atëherë përfaqësuesit e kësaj shkolle mirëpritën iniciativën për ridizajnimin e këtij lokacioni dhe ndanë përvojat dhe propozimet e tyre. Prezent në këtë puntori ishin banorë, përfaqësues të Policisë së Kosovës, kalimtarë dhe punonjës në institucionet në afërsi. Këta njëzëri u shprehën se kjo hapësirë ka mungesa të theksuara sa i përket dizajnit dhe përmbajtjes në shërbim të komunitetit dhe ka nevojë urgjente që të intervenohet pasi që në këto rrethana ku kjo hapësirë është plotësisht e padukshme nga rruga kryesore, ku nuk ka ndriçim dhe qarkullim të njerëzve, është shndërruar në një zonë të përshtatshme për grupet e dyshimta. Në këtë mënyrë kjo hapësirë është e pasigurt për qytetarët. Policia e Kosovës në anën tjetër konfirmoi këto probleme dhe theksoi që Policia është e gatshme që të jap kontributin e vet për një zgjidhje konkrete lidhur me përmirësimin e situatës së sigurisë në këtë hapësirë publike në Prizren.

Banorët e tjerë të kësaj lagjeje ritheksuan faktin se problemet në këtë hapësirë janë të mëdha, mirëpo intervenimet primare duhet të realizohen në infrastrukturë e pastaj të arrijmë deri tek një gërshetim i funksionalizimit të tërë kësaj zone, duke bërë ndërlidhjen e këtij parku edhe me monumentet e trashëgimisë kulturore që gjinden përreth gjë që do të rezultonte edhe me hapjen e tyre duke i vënë në funksion të të gjithë qytetarëve dhe vizitorëve.



Metodologjia dhe mjetet e punës

Punëtorja “Hapësira publike të sigurta dhe mikpritëse për gratë dhe vajzat” duke pasur në fokus gratë dhe vajzat që banojnë në hapësirën që e rrethon parkun të cilin e trajton ky vizionim, është bazuar në diskutime të hapura ku pjesëmarrëset kanë shfaqur raportin e tyre lidhur me këtë pjesë të qytetit. Pas diskutimeve të pranishmit kanë plotësuar një pyetësor përmes të cilit kanë shfaqur specifikisht shqetësimet dhe propozimet e tyre, për të vazhduar më tej me punën në grupe fazë në të cilën pjesëmarrëset kanë pasur mundësinë që të intervenojnë direkt në parkun e paraqitur në hartë, duke propozuar vendet e akomodimit të mobiliarisë urbane dhe ndryshimet e tjera të kërkuara nga to. Këto propozime sjellin si rezultat gjithëpërfshirje në vizionimin e paraqitur në këtë publikim.

Punëtorja “Hapësira publike të sigurta dhe mikpritëse për gratë dhe vajzat” është konceptuar në katër faza të punës, ku në fazën e parë është bërë hulumtimi i gjendjes ekzistuese, në fazën e dytë është diskutuar problemi me të pranishmit, tek faza e tretë është bërë anketimi i pjesëmarrësve dhe në fazën e katërt janë dhënë propozimet direkte për intervenim.

Materialet e punëtorisë

Për të realizuar të gjitha fazat e punëtorisë, është parë e nevojshme aplikimi i këtyre materialeve:

- pyetësori
- harta të lokacionit të shqyrtuar
- fotografi të lokacionit të shqyrtuar
- letër për punimin e maketës
- ngjyra dhe letra me ngjyrë
- laptop dhe projektor

Fazat e punëtorisë

Hapësira të cilën e trajton ky vizionim është shfaqur si një pjesë problematike nga banorët e kësaj lagjeje gjatë takimeve të EC me banorët e lagjeve të Prizrenit dhe poashtu është një nga të gjeturat e hulumtimit të mëparshëm “Siguria në Hapësirat Publike” dhe ligjëratave të mbajtura me Shkollat e mesme të ulta të Prizrenit. Si rrjedhojë e kësaj, faza e parë e punëtorisë kishte të bënte me hulumtimin e gjendjes ekzistuese në terren, ku profesionistët janë angazhuar për t’i bërë matjet, vizatimet dhe identifikimin e problemeve urbane që ky park i përmban.

Pas fazës së parë janë kontaktuar banorët dhe janë mbledhur për të diskutuar tutje këto probleme nga këndvështrimi i tyre si qytetarë që përballen çdo ditë me shqetësimet që i’u shkakton kjo hapësirë. Duke e pasur si synim listimin e problemeve që këta banorë i hasin në përditshmëri në shfrytëzimin e këtij parku atëherë punëtorja ka filluar me një diskutim të përgjithshëm ku secili nga pjesëmarrësit ka ndarë përvojat dhe ankesat e tyre lidhur me çështjen e sigurisë në këtë pjesë.



Faza e tretë e punëtorisë i është kushtuar një pyetësi ku secili pjesëmarrës ka dhënë opsionin e vet për mënyrat më të përshtatshme për rifunksionalizimin e këtij parku. Në këtë pyetësor pjesëmarrësit kanë pasur mundësinë të propozojnë aktivitetet që do të dëshironin t'i zhvillonin dhe elementet që ata mendojnë se do të duhej të shtoheshin në mënyrë që të rritej shfrytëzimi i hapësirës publike në afërsi të Gjimnazit “Remzi Ademaj”.

Në fazën e katërt pjesëmarrësve i'u është prezantuar lokacioni i paraqitur në hartë, ku të pranishmit kanë dhënë propozimet direkte së çfarë i'u duket më e nevojshme për t'u vendosur apo ndryshuar në secilën pjesë të parkut.




Ecuria e punëtorisë

Puntoria e vizionimit ka pasur në fokus realizimin e fazave të përcaktuara në metodologjinë e punës, andaj fillimisht pjesëmarrësve i'u është dedikuar një kohë për të diskutuar shqetësimet dhe kërkesat kryesore sa i përket hapësirës publike përballë Gjimnazit "Remzi Ademaj". Në fund të diskutimit, pjesëmarrësit kanë plotësuar pyetësorët e shpërndarë, të cilët janë dizajnuar paraprakisht duke u bazuar në metodologji të aplikuara tashmë në planifikim urban me pjesëmarrje. Pas përfundimit të diskutimeve dhe plotësimit të pyetësorëve individual, pjesëmarrësit janë ndarë në dy grupe, për të diskutuar më detajisht lokacionin e caktuar. Fillimisht në hartat e përgatitura janë identifikuar problemet dhe shqetësimet kryesore. Në fokus ishte çështja e krijimit të një ambienti që do të ofronte siguri për të qenë gratë dhe vajzat shfrytëzuese të kësaj hapësire. Gjatë këtyre fazave gratë patën mundësinë që në bashkëpunim me fasilitatorët t'i prioritizojnë kërkesat e tyre dhe më pas të japin propozime konkrete lidhur me përmirësimin e kualitetit të ambientit në këtë park.

Rezultatet e puntorisë

Të dhënat e dalura nga pyetësorët

Të gjithë pjesëmarrësit i'u nënshtruan procesit të plotësimit të pyetësorëve, gjithsej 12. Në mesin e pjesëmarrësve kishte banorë të lagjes, punëtorë të institucioneve në afërsi dhe kalimtar. Kategorizimi i pjesëmarrësve në bazë të gjinisë është i prezantuar më poshtë.




Graf. 1. Pasqyra e pjesëmarrësve sipas gjinisë

Rezultatet e anketimit janë prezantuar më poshtë, duke dhënë grafikisht të paraqitura përgjigjet e pjesëmarrësve si dhe komentet lidhur me ndikimin e rezultateve në procesin e vizionimit.


1. Cili është relacioni juaj me hapësirën publike përballë Gjimnazit “Remzi Ademaj”?

Numri më i madh i pjesëmarrësve në këtë punëtori ishin banorët e lagjes në të cilën gjendet hapësira që ky vizionim e trajton. Përveç banorëve të lagjes të pranishëm ishin edhe punëtorët e institucioneve në afërsi dhe kalimtarët të cilët janë potencial i rëndësishëm për shfrytëzimin e këtij parku.




2. A e vizitoni hapësirën publike përballë Gjimnazit “Remzi Ademaj”?

83.3 % e respondentëve janë deklaruar se nuk e vizitojnë këtë hapësirë, ndërsa vetëm 16.7 % janë përgjegjur pozitivisht. Përqindja e lartë në favor të atyre që e shmangin këtë hapësirë është një evidencë që në parkun përballë Gjimnazit “Remzi Ademaj” mungojnë shumë elemente të cilat i sjellin këto rrethana.




3. Cilat janë arsyet që nuk e vizitoni këtë park?

Të anketuarit kanë vënë në pah se prania e grupeve të dyshimta qëndron mbi të gjitha arsyet tjera që ndikojnë në pasigurinë e tyre në këtë hapësirë publike, duke u përcjellur me mungesën e përmbajtjes ku hyn mungesa e ndriçimit publik dhe mobiliarisë urbane. Ndër arsyet e tjera me më pak përqindje janë listuar prania e qenve endacak dhe pakujdesia në trafik.




4. Bazuar në situatën aktuale a është kjo hapësirë e sigurtë?

100 % e të anktuarve janë deklaruar se në situatën aktuale kjo hapësirë publike është e pasigurtë për t'u frekuentuar nga këta qytetarë.




5. Nëse jo, a e keni raportuar ndonjëherë këtë në organet e rendit?

Përkundër përqindjes së lartë të respondentëve që deklarojnë se nuk ndihen të sigurtë në shfrytëzimin e hapësirës publike përballë Gjimnazit “Remzi Ademaj”, përqindja më e madhe e të anketuarëve janë përgjegjur negativisht lidhur me faktin se a kanë raportuar këto shqetësime tek organet përgjegjëse të sigurisë.




6. Cilat nga aktivitetet e mëposhtme do të donit t'i ushtronit në këtë hapësirë?

Kalimi i kohës së lirë, dalja në pauzën e drekës dhe pirja e kafesë janë arsyet që kanë dominuar në pyetjen mbi arsyen e shfrytëzimit të kësaj hapësire publike. Tek të tjerat pason shoqërimi i familjarëve dhe leximi.




7. Sipas vlerësimit tuaj të përgjithshëm cilat nga shërbimet e mëposhtme i duhen hapësirës publike përballë Gjimnazit “Remzi Ademaj”?

Bazuar në përgjigjet e të anketuarëve del të jetë se të gjitha opsionet e ofruara në këtë pyetje janë të nevojshme që të ofrohen si shërbime të cilat do të ngjallnin këtë hapësirë publike duke ofruar përmbajtje dhe komoditet për frekuentuesit. Primare shfaqet prezenca e ndriçimit publik pasi që ky element do të rriste nivelin e sigurisë dhe ofrimi i shërbimeve të tjera si hapësirat për ulje, hapësirat gjelbëruese dhe ofrimi i çajit apo kafes janë ndër opsionet e tjera të sugjeruara.



8. Cilat nga elementet e mëposhtme do të përmirësonin shfrytëzimin e hapësirave publike në afërsi të Gjimnazit “Remzi Ademaj”?

Lidhur me elementet që do të përmirësonin shfrytëzimin e hapësirave publike në Prizren, të anketuarit janë deklaruar me përqindjen më të madhe për sigurinë në lëvizje me 36%, për të vazhduar infrastrukturë më të mirë publike, me shërbime më të mira komunale dhe aktivitete për fëmijë. Aktivitetet sportive dhe kulturore janë listuar me përqindjen më të ulët.



Identifikimi i problemeve

Përpos të gjeturave nga rezultatet e pyetësorëve me pjesëmarrësit e anketuar si dhe observimi direkt i lokacionit, diskutimi i hapur ka dhënë një sërë rezultatesh sa i takon problematikave dhe propozimeve lidhur me parkun përballë shkollës "Remzi Ademaj".

Në punëtorinë e realizuar me banorë dhe shfrytëzues të tjerë të parkut përballë Gjimnazit "Remzi Ademaj" kanë dalur komponente të ndryshme që i shërbejnë këtij raporti për të krijuar një zgjidhje të qëndrueshme. Duke qenë se në këtë park mungon përmbajtshmëria e cila do të ofronte komoditet atëherë fokusi i pjesëmarrësve ka qenë në shtimin e elementeve të ndryshme që do të krijonin një hapësirë e cila do të ishte mikpritëse dhe e sigurtë për të gjitha kategoritë e komunitetit.

Parku përballë gjimnazit "Remzi Ademaj" gjindet në bërthamën e Qendrës Historike të Prizrenit, dhe është identifikuar si pjesë problematike dhe jashtë funksionit paraprakisht edhe nga Plani i Menaxhimit të QHPz.² Dizajni jo i mirë i këtij parku është problem thelbësor që e hasim këtu dhe që rrjedhimisht i sjell të gjitha problemet tjera të cilat e kanë shndërruar këtë park në një hapësirë jashtë funksionit. Ky park është i ndarë në dysh, ku pjesa lartë përskaq rrugës është e shkëputur në pamje nga pjesa e poshtme e tij rreth lumit. Si pasojë e këtij planifikimi pjesa që shtrihet poshtë përskaq lumit është e panjohur për shumicën të cilët kalojnë përskaq. Pra, pjesa më problematike e këtij lokacioni shfaqet të jetë pjesa rreth lumit e cila është zona më e rëndësishme e këtij parku.

Kjo hapësirë publike përveç që pjesën më të rëndësishme e ka të shmangur, aty poashtu ka edhe mungesë të theksuar të elementeve bazike urbane që shkaktojnë mungesë të sigurisë dhe mungesë të qarkullimit të njerëzve. Si pasojë e infrastrukturës së papërshtatshme banorët vazhdimisht e kanë shmangur këtë pjesë pasi që aty ka mungesë të ndriçimit publik, mungesë të ulëseve, të hapësirës së gjelbërt - në një fjalë ka mungesë të përmbajtjes në shërbim të komunitetit.



² http://ecmandryshe.org/repository/docs/180119152201_Hulumtimi_Hap__sirat_Publike_2017_1.pdf

Si pasojë e këtij dizajni ka ardhur deri tek përjashtimi i komunitetit të banorëve që jetojnë përreth. Duke qenë se kemi mungesë të ndriçimit publik dhe infrastrukturë e cila nuk është e përshtatshme për të zhvilluar aktivitete nga banorët, atëherë ky park është shndërruar në një zonë të përshtatshme për të zhvilluar aktivitete të tyre grupet e dyshimta. Banorët kanë shfaqur si shqetësim të madh praninë e përdoruesve të drogës. Duke qenë se ky park është i padukshëm nga pjesa lartë e rrugës, ka mungesë qarkullimi dhe errësirë, atëherë grupet e dyshimta lirshëm i kryejnë aktivitete të tyre. Banorët dhe përfaqësuesit e shkollës thonë se vazhdimisht janë ankuar tek institucionet, mirëpo ky problem nuk ka marrë zgjidhje.

EC në bashkëpunim me banorët është angazhuar që të krijojë mundësinë e zhvillimit të përmbajtjeve të reja funksionale që do të rrisin sigurinë dhe do të zëvendësonin aktivitete të grupeve të dyshimta në këtë zonë.

Zgjidhja

Vizionimi i hapësirës publike përballë gjimnazit "Remzi Ademaj" konsiston në propozimin e një zgjidhjeje të re funksionale e cila ofron funksionalitet maksimal për të gjitha grupet e komunitetit. Bazuar në rekomandimet e dalura nga punëtorja dy ditore dhe në praktikat e mira ndërkombëtare është dhënë propozimi konceptuel i ridizajnit të këtij lokacioni. Duke qenë se problem kryesor i identifikuar në të gjitha fazat është që kjo hapësirë nuk ka përmbajtje dhe aty ka prani të grupeve të dyshimta, atëherë vizionimi synon që të eliminojë këto probleme përmes intervenimeve direkte që do të sillnin përmbajtje e cila do të krijonte siguri për frekuentim të kësaj zone.



Meqenëse ekziston një shkëputje vizuale nga pjesa e parkut përreth rrugës dhe pjesa rreth lumit, atëherë ky vizionim parasheh vendosjen e disa shkallëve me strukturë metalike që do të shkrinin këtë shkëputje dhe do të bënin lidhjen direkte të këtyre dy pjesëve dhe poashtu shkallët aktuale janë rimenduar në këtë vizionim me qëllim të bërjes më të dukshme të pjesës përskaj lumit. Përveç kësaj si propozim i banorëve doli që ndërlihdja e këtij parku të bëhet edhe me objektet e tjera të trashëgimisë kulturore që gjenden përreth. Propozimi i tyre ishte që objekti i Kuvendit të Beledijes të lidhet me parkun përmes jazit, ku mbi këtë jaz të bëhet një shëtitore me konstruktion metalik e cila do të të dërgonte direkt në park dhe si rezultat do të sillte edhe qarkullimi dhe interesim më të madh të njerëzve.





Vendosja e mobilirisë urbane në këtë park është pjesa tjetër që e parasheh ky vizionim. Në momentin kur frekuentuesit do të kenë hapësira të cilat do të mund t'i shfrytëzojnë qoftë për t'u ulur për një kohë të caktuar apo për ndonjë aktivitet ditor, atëherë do të shtohet interesimi për këtë park nga grupet e ndryshme të komunitetit si prindërit, pleqtë, gratë, të rinjtë etj. Vendosja e ulseve përreth lumit doli si një kërkesë nga banorët, duke qenë se këto ulëse veçse kanë qenë më parë të vendosura në atë mënyrë dhe për këta qytetarë kjo iu sjell edhe nostalgji për kohën që e kanë kaluar të ulur përreth lumit.

Ndriçimi është element i radhës që është theksuar vazhdimisht dhe është një nga çështjet kryesore që kërkon zgjidhje urgjente. Mungesa e ndriçimit në këtë hapësirë publike është një nga arsyet kryesore pse ka mungesë të sigurisë aty dhe pse ky park është shndërruar në një zonë komforti për grupet e dyshimta. Ky vizionim parasheh që të vendoset ndriçim i mjaftueshëm që do të rriste nivelin e sigurisë për frekuentuesit e kësaj hapësire publike.



Si synim kryesor i këtij projekti qëndron të jetë rifunksionalizimi i kësaj hapësire përmes sjelljes së përmbajtjes që do të ishte në shërbim të komunitetit dhe rrjedhimisht do të eliminonte dukuritë negative përmes frekuentimit këtij lokacioni nga njerëzit. Si një shërbim të radhës që parashihet të vihet në funksion është një Pop-up³ ku personat të cilët e vizitojnë këtë hapësirë të mund të shërbehen me pije dhe ushqime të cilat do të mund t'i konsumonin në këtë park. Vendosja e këtij shërbimi është dëshmuar si një sukses i madh nëpër qytetet e ndryshme të botës në futjen në funksion të hapësirave të braktisura. Cecilia Anderson, e cila drejton programin për hapësirat publike në UN-Habitat, agjencinë udhëheqëse të U.N. për çështjet urbane thot se "Nganjëherë mjafton të bësh një pop-up të vogël në hapësirën publike vetëm për të shfaqur se çfarë përfitimesh sjell ajo për qytetin, qytetarët dhe lagjen."⁴ Me vendosjen e një shërbimi të tillë do të vinin si rezultat një varg elementesh tjera që do të kontribuonin pozitivisht në mirëmbajtjen e kësaj hapësire. Duke qenë se do të jetë një personi cili do të angazhohet në drejtimin e këtij shërbimi, atëherë ai një një mënyrë do të jetë vëzhgues i këtij parku dhe rrjedhimisht parregullsitë dhe dëmet ndaj kësaj hapësire do të ishin më pak prezente dhe do të shtohesh mirëmbajtja e këtij parku.

³ Pop up - Një dyqan i vogël mobil që shërben për konsumim

⁴ <https://www.reuters.com/article/us-malaysia-cities-public/can-pop-ups-pave-the-way-to-thriving-public-space-in-worlds-cities-idUSKCN1GP1HW>



Ky vizionim parasheh edhe vendosjen e një këndi të lojrave për fëmijë që do të shtonte përmbajtjen e kësaj hapësire. Si rezultat do të sillte frekuentim më të madh të prindërve me fëmijët e tyre.



Konkludim

Problemet që ndërlidhen me hapësirat publike në përgjithësi janë të shumta. Meqenëse gjatë pothuajse dy dekadave planifikimi i hapësirave publike në Kosovë bëhet pa dëgjuar paraprakisht nevojat e komunitetit, atëherë këto plane të hartuara janë plotësisht jashtë shërbimit ndaj banorëve. Projektet e dizajnuara në këtë formë nuk e reflektojnë ndjenjen e bashkëpronësisë së hapësirës publike, nuk kanë përmbajtje që përmbushin nevojat e qytetarëve, pra rrjedhimisht këto hapësira shndërrohen në zona të braktisura ashtu siç ka ndodhur edhe me parkun përballë gjimnazit “Remzi Ademaj”, hapësirë të cilin e trajton ky raport.

Në përfundim duhet ritheksuar se një qytet gjithëpërfshirës duhet të ketë hapësira të cilat nuk krijojnë përjashtime për asnjë grup të komunitetit dhe promovojnë barazi dhe zhvillim. Një qytet i mirë ndërtohet nga vetë banorët duke i bërë ata pjesë të proceseve vendimmarrëse dhe vetëm në këtë mënyrë mund të arrihet një zhvillim i qëndrueshëm urban.

Vizuelizimet









